



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 41 Prot.

Tiranë, më 19/01/2012

Lënda: Rekomandim për, Av.Luan Merlika, Tiranë.

REKOMANDIM

Nr. 03, datë 19/01/2012

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, **Av. Luan Merlika**, me adresë: Bul” Zogu i Parë”, VEVE Business Center, Tiranë,

KONSTATOVA

Më datë 04/11/2011, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, **Av.Luan Merlika, Tiranë**, me cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

1. Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale në Listpagesën e Kontributeve Shoqërore, shëndetësore, Tatimit mbi të ardhurat, për të gjithë punëmarrësit e SHOQËRISË “Rofix”, sh.p.k., për periudhën Janar 2009 – Dhjetor 2010, të përhapura tek kontrolluesi Person Fizik, z. Luan Merlika, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, me adresë: Rr. “Muhamet Gjollësja, Blloku Partizani, P.62/1, Tiranë, nëpërmjet përgjigjes së dhënë dhe dokumentacionin shoqërues në vijim të kërkesës Nr.21/7, datë 21.07.2011.
2. Verifikimi i gjendjes së përpunimit të të gjitha të dhënave, Listpagesës së Kontributeve Shoqërore, shëndetësore, Tatimit mbi të ardhurat, për të gjithë punëmarrësit e Shoqërisë “Rofix”, sh.p.k., për periudhën Janar 2009 – Dhjetor 2010, bazuar në nenet 5, 6, dhe 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në lidhje me:
 - Qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të gjitha të dhënave, Listpagesës së Kontributeve Shoqërore, shëndetësore, Tatimit mbi të ardhurat, për të gjithë punëmarrësit e Shoqërisë “Rofix”, sh.p.k., për periudhën Janar 2009 – Dhjetor 2010.
 - Verifikimi i mënyrave dhe mjeteve të përpunimit të këtyre të dhënave, nëse janë përpunuar plotësisht ose jo me mjete automatike (kompjuterike), ruajtur, ndryshuar, arkivuar, fshirë apo shkatëruar;

- Verifikimi nëse këto të dhëna janë përhapur në subjekte të tjerë kontrollues, si dhe identifikimi i këtyre subjekteve, përkundrejt qëllimit;
- Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave;
- Saktësinë dhe qartësinë në përpunimin e të dhënave;
- Verifikimi i kategorive të subjekteve që ju përpunohen të dhënat, përkundrejt qëllimit.

Në kuadër të masave të mara nga KMDP, për parandalimin e mundshëm të një përpunimi të paautorizuar apo keqpërdorimi të të dhënave të siguruara nga kontrolluesi Av. Luan Merlika, Komisioneri me autoritetin dhe kompetencat që ligji i jep, konkretisht Neni 30/1/b të ligjit të sipërcituar,

“1. Komisioneri ka këto të drejta:

b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale;”, si dhe bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, Neni 78, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka të drejtën dhe detyrimin ligjor të dalë me vendim të ndërmjetëm.

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 5/1/b,c, 30 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nenit 78, 79 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri me autoritetin që i jep ligji, doli me vendim Vendimin e ndërmjetëm Nr. 31, datë 26.12.2011 sipas të cilit vendosi:

1-Bllokimin dhe pezullimin e përpunimit të mëtejshëm nga ana Juaj të të dhënave personale që përmbahen në listpagesat e punonjësve të shoqërisë “Roefix” për periudhën janar 2009-dhjetor 2010 deri në dhënien e vendimit përfundimtar në lidhje me çështjen nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nga kontrolli administrativ i ushtruar, pranë kontrolluesit Av. Luan Merlika, kontroll fizik i të gjitha dosjeve, që kontrolluesi administronte, si dhe kontrolli i sistemit kompjuterik, në zbatim të Urdhërit, Nr. 78, datë 26.12.2011, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u konstatua:

1. Listpagesa e Shoqërisë “Rofix” sh.p.k, për periudhën Janar 2009-Dhjetor 2010, në mënyrë manuale nuk ekzistonte dhe nuk disponohej fizikisht në zyrën e Av. Luan Merlika dhe sipas sqarimeve të mëtejshme të tij, kjo listpagesë ishte e depozituar në dosjen gjyqësore e cila ndodhej për shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë.
2. Listpagesa e Shoqërisë “Rofix” sh.p.k, për periudhën Janar 2009-Dhjetor 2010, në mënyrë elektronike, gjithashtu nuk figuronte.

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të datës 29.11.2011 të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të Z. Gjergji Bicolli(ish-punonjës i Shoqërisë “Roefix”), me anë të kërkesës Nr.27/1 prot, datë 21.07.2011, Av.Luan Merlika, ka kërkuar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë listpagesën për periudhën për periudhën janar 2009-dhjetor 2010, për të gjithë punonjësit e shoqërisë “Rofix”.

Me anë të shkresave Nr.8522 prot, datë 16.08.2011, 8047/1, datë 19.07.2011 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë është vënë në dispozicion të këtij kontrolluesi, listpagesa për periudhën e sipërcituar, fotokopje e njësuar me origjinalin. Kjo listë është e detajuar dhe përmban listpagesën e kontributeve shoqërore, shëndetësore, tatimit mbi të ardhurat nga punësimi të të gjithë punonjësve. Kjo listë pagesë është depozituar në cilësinë e provës pranë Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë. Në këto kushte, nga Av. Luan Merlika kemi mbledhje dhe përhapje të të dhënave të mbledhura nga DRSSH Tiranë.

Sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” , nenit 5, gërma b, c, i cili shprehet: *b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime; c)*..të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim”, të dhënat që ju keni grumbulluar si rezultat i korrespondencës me DRSSH, Tiranë e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë mbledhur. Ju keni grumbulluar të dhëna personale jo vetëm për klientin që keni përfaqësuar ligjërisht, i cili në bazë të nenit 12 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” ka të drejtën e aksesit në të dhënat e tij të mbledhura nga kontrolluesi, por edhe për të gjithë punonjësit e tjerë të shoqërisë “ Roefix”, çfarë rezulton në kundërshtim me nenin e sipërcituar.

Përvec sa më sipër, mbledhja e të dhënave për gjithë punonjësit, pa dijeninë e tyre, nga Av.Luan Merlika përvec të dhënave të klientit që ka përfaqësuar ligjërisht në bazë të prokurës së posaçme, çënon privatësinë e çdo individi, punonjës i shoqërisë “ Rofix”.

Përdorimi i të dhënave të këtyre punonjësve në mënyrë të paautorizuar, mund të sjellë dëme të rëndë dhe të pariparueshme në lidhje me interesat e tyre dhe privatësinë, si një nga të drejtat themelore të parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 35 dhe Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Formulimin e kërkesave më të plota drejtuar institucioneve publike, duke saktësuar qëllimin për të cilat mblidhen, grumbullohen dhe përpunohen të dhënat, për subjektet që përfaqësoni ligjërisht;
2. Të gjitha të dhënat që mblidhen, grumbullohen dhe përpunohen për qëllim të aktivitetit të avokatit nuk duhen përdorur për qëllime të tjera, ndryshe nga ato për të cilat ato janë mbledhur.

KOMISIONERI

